



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.357/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjor Florije Krasniqi - Pireva, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nexhmedin Hyseni, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit për Koordinimin në Teren, nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ka paraqitur ankesë kundër Komisionit Komunal Zgjedhor në Komunën e Rahovecit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 11.02.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e palejuar ankesa Anr. 357/2021 i datës 09.02.2021, i paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor në Komunën e Rahovecit, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021.

## **A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e Drejtorit të Departamentit për Koordinim në Teren, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ, ka paraqitur ankesë në PZAP, më datë 09.02.2021, me të cilën pretendon se më datë 09.02.2021, ka kërkuar nga Komisioni Komunal Zgjedhor në Rahovec- KKZ, që bëjë rregullimin listës lidhur me përbërjen e Ekipit Mobil, për votuesit me Covid-19, ndërsa anëtarët e KKZ-së, e kanë kundërshtuar të punojnë në mënyrë profesionale duke vepruar në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes, gjë që dëmton procesin dhe integritetin e zgjedhor. Mëtej parashtruesi i ankesës, ka shtuar se në mënyrë të jashtëligjshme anëtarët e KKZ-së, Alirizah Cana, Kreshnik Haxhijaha, Faton Rexhepi, Emin Shehu dhe Mirosllav Maritoseviq, kanë kundërshtuar përbërjen e anëtarëve të Ekipit Mobil prej 4 anëtarëve, ku 3 prej tyre duhet të jenë nga subjektet politike dhe një anëtarë punëtor shëndetësor. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur korrespondencën e bërë përmes email-it me KKZ-në Rahovec si dhe Procesverbalet e takimeve të KKZ-zë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Me nenin 70 paragrafi 1 pika a) i LZP-së, përcakton se: “KQZ-ja mund ta revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtarë të KKZ-së, nëse anëtari: a) nuk i kryen detyrat e tij/saj sipas rregullave të KQZ-së”.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerësoi se në kuptim të dispozitës së lartcekur ligjore, ankesa është e palejuar, pasi që parashtruesi i ankesës ka ankimuar Komisionit Komunal Zgjedhor-KKZ, për mos kryerjen e detyrave të përcaktuara, e që kjo nuk është në juridiksionin e PZAP-së, sipas nenit të lart cituar.

Meqenëse pretendimet ankimore siç u cek më lartë hynë në kuadër nuk hynë në juridiksionin e PZAP-së, andaj Paneli nuk u lëshua në vlerësimin meritore të çështjes, pasi që vlerësoi se këto pretendime ankimore nuk mund të ankimohen në PZAP, për arsyet e cekura më lartë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 6 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 357/2021 më datë 11.02.2021



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.